



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE SOCIALE  
DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL

Nr. prot. \_\_\_\_\_

Tiranë 21.11, 2019

Lënda: **Kthim përgjigje**

✓ Z.

e-mail \_\_\_\_\_

tel: \_\_\_\_\_

E nderuar znj.

Në përgjigje të kërkesës suaj Nr. P - 26409, datë 12.11.2019, Drejtoria e Strehimit Social ju bën me dije se:

1. Buxheti i përcaktuar për vitin 2019 në zbatim të këtyre programeve është 69.841.800 lekë. Buxheti i planifikuar në PBA 2019-2021 për implementimin e programeve sociale të strehimit është 210.537.600 lekë.

2. Numri i përfituesve të programit Bonus Strehimi, për vitin 2019 janë:

VKB Nr. 07 Datë: 31.01.2019 - 27 përfitues

VKB Nr. 30 Datë: 03.05.2019 - 100 përfitues

VKB Nr. 63 Date: 07.06. 2019 - 23 përfitues

VKB Nr. 118 Datë: 25.10.2019 - 38 përfitues

3. Kriteret për të përfituar nga programet sociale të strehimit parashikohen në nenin 4, 5 të ligjit 9232 datë 13.5.2014 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" si më poshtë:

**Përcaktimi i familjeve që përfitojnë nga programet sociale të strehimit**

1. Sipas këtij ligji, përfitojnë strehim individët, që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë;

b) zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike, ku bëjnë pjesë këto familje, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;

c) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore.

2. Përfshihen në njërin nga shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni vetëm ato familje, që kanë të ardhura të pamjaftueshme, sipas përcaktimeve të neneve 6 e 19 të këtij ligji.

3. Përfitojnë sipas programeve të përcaktuara në krerët III dhe IV të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin:

a) "punëtor emigrant";

b) "azilkërkues".

**Përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet sipas një sistemi pikëzimi, me anë të të cilit vlerësohen:**

a) Kushtet e strehimit, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi familjet që:

i) nuk disponojnë banesë në pronësi;

ii) banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembjeje;

iii) banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;

iv) kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.

b) Kushtet familjare, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) familjet njëprindërore, që kanë në ngarkim fëmijë;

ii) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;

iii) familjet me më shumë se katër fëmijë;

iv) çiftet e reja me moshë totale deri në 60 vjeç.

c) Kushtet sociale, në bazë të të cilave përcaktohen me përparësi rastet e mëposhtme:

i) personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori;

ii) personat me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç;

iii) emigranti i rikthyer, punëtor emigrant;

iv) familjet e policëve të rënë në detyrë;

v) viktimat e dhunës në familje.

ç) Gjendja ekonomike, në bazë të së cilës përcaktohen familjet sipas grupeve të të ardhurave.

4. Në lidhje se sa familje mbeten pa u trajtuar me Bonus Strehimi në një vit, nuk mund t'iu japim shifër të saktë, pasi një individ/ familje mund të aplikojë disa here edhe pse nuk shpallet përfitues që herën e parë.

5. Bashkia për vitin e ardhshëm po punon për të përditësuar praktikën për programet e strehimit me ndryshimet e reja ligjore, përkatësisht ligji 22/2018 "Për strehimin social" dhe aktet nënligjore për zbatim të tij.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

